



**Ndajfolje** quhen fjalët e pandryshueshme që plotësojnë para së gjithash foljen, duke treguar mënyrë, vend, kohë, shak, qëllim, sasi: Blendi shkruan bukur, qartë dhe saktë.

Ndajfoljet mund të plotësojnë edhe një mbiemër ose ndajfolje tjetër:

Detyra ishte tepër e vështirë.  
Ata u ngritën shumë herët atë ditë.

Por nga kuptimi ndajfoljet janë gjashtë llojesh:  
mënyre, vendi, kohe, shkak, qëllimi, sasi.

### **NDAJFOLJET E MËNYRËS**

Ndajfoljet e mënyrës luajnë rolin e grupeve parafjalore rrethanor mënyre:  
Vjollca e Dritani silleshin natyrshëm (=në mënyrë të natyrshme) me të gjithë.

Ndajfoljet kryesore të mënyrës janë:

- mirë, keq, bukur, pastër, qartë, shkurt, thjesht, që tregojnë cilësinë e veprimit. Të tilla janë edhe ndajfoljet gëzueshëm, natyrshëm, furishëm, etj.;

Vjollca flet bukur frëngjisht.

- menjëherë, pak nga pak, vazhdimisht, shpesh, papritur, etj. Që tregojnë ecurinë e veprimit:  
Dritani u ngrit papritur.

- cekët, gjerë, gjtë, thellë, ulët që tregojnë përmasa:  
Toka duhet punuar thellë.

- bujarisht, trimërisht, artistikisht, besnikërisht, teorikisht, që kanë kuptimin e togut në mënyrë + mbiemër: bujarisht (në mënyrë bujare), po edhe shqip, frëngjisht, anglisht:  
Në Shqipëri më pritën dhe më përcollën bujarisht (në mënyrë bujare).

### **NDAJFOLJET E VENDIT**

Ndajfoljet e vendit luajnë rolin e grupeve parafjalorë plotës vendi.

Ndajfoljet kryesore të vendit janë:

- afër, larg, pranë, rreth, djathtas, majtas, aty, atje, diku, gjëkund, gjithkund, anëmbanë, gjithandej, kudo, ngado, asgjëkund, kurrkund, etj, që tregojnë vendin ku kryhet veprimi: Makina u kthye djathtas (në anën e djathtë).

- ku, nga:

Ku po shkon ?

Nga je edhe pse ke ardhur ?

Në të vërtetë ku dhe nga janë ndajfolje pyetëse, po merren edhe si ndajfolje vendi:

### **NDAJFOLJET E KOHËS**

Ndajfoljet e kohës luajnë rolin e grupeve parafjalore rrethanor kohe.

Ndajfoljet kryesore të kohës janë :

- dje, pardje, nesër, pasnesër, paradite, pasdite, sot, sonte, tani, vjet, që tregojnë kohën e saktë të kryerjes së veprimit:

Erdha sot (=ditën e sotme) nga Tirana dhe do të nisem nesër (ditën e nesërme).

- njëherë, një herë e një kohë, gjithmonë, kurdo, së shpejti, së lashti, që tregojnë një kohë të papërcaktuar:

Së shpejti do të organizohet në Tiranë një konferencë për gjuhën shqipe.

### **NDAJFOLJET E SHKAKUT**

Ndajfoljet e shkakut luajnë rolin e një grupi parafjalor rrethanor shkak.

Ndajfoljet e shkakut janë: përse, pse të cilat përdoren për të pyetur për shkakun e kryerjes së një veprimi:

Pse (për çfarë arsyeje) nuk punon edhe ti si të tjerët?

Përse (për çfarë qëllimi) më kërkon?

Këtu mund të fshihen edhe fjalët prandaj, andaj, (=për këtë shkak, për këtë arsye, për këtë qëllim) të cilat funksionojnë edhe si lidhëza.

### **NDAJFOLJET E SASISË**

Ndajfoljet e sasisë luajnë rolin e grupeve emërore rrethanor sasisë.

Ndajfoljet kryesore të sasisë janë:

- shumë, pak, tepër, fort, së tepërmi, për së tepërmi, njëherë, dyherë, etj, që tregojnë në ç`masë realizohet veprimi:

E njoh mirë Butrintin, se e kam vizituar tri herë.

Gjeta një libër shumë të vjetër, të ruajtur shumë mirë.

- fort, tepër, së tepërmi, njëfish, dyfish, trefish, aq, kaq, mjaft, pak, etj. që shprehin intensitetin ose shkallën e një veprimi a të një cilësie.

Dëgjomë, mua plakun, se di më tepër se ti.

### **SHKALLËT E NDAJFOLJEVE**

Ndajfoljet përdoren në shkallën pohore, krahasore dhe sipërore, kryesisht ndajfoljet e mënyrës:

mirë, bukur, qartë, si edhe disa ndajfolje vendi e kohe: lart, poshtë, afër, larg, vonë, herët, etj.

Shkalla krahasore dhe shkalla sipërore e ndajfoljeve formohen me po ato fjalë me të cilat formohen shkalla krahasore e shkalla sipërore e mbiemrave.

- Shkalla pohore  
Miri ecën shpejt

- Shkalla Krahasore  
e barazisë : Mirri ecën aq shpejt sa Genti.  
e sipërisë : Miri ecën më shpejt se Genti.  
e ultësisë : Miri ecën jo aq shpejt sa Genti.

- Shkalla sipërore  
Miri ecën shumë shpejt.

Marrë nga: [abcshqip.com](http://abcshqip.com)